



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KRYETARI**

Nr. 6913 prot.

Tiranë, më 0.2 2025

V E N D I M

Nr. 88 datë 0.2 2025

P Ë R

PLANIN VJETOR PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË SHËRBIMIN CIVIL

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", si dhe Urdhërit të Kryetarit nr.3492, nr.Prot. 49222 datë 24.12.2024 për "Miratimin e Strukturës dhe organikës së institucionit të Bashkisë së Tiranës", si rezultat i krijimit të vendeve vakante;

VENDOSA:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2025 në Bashkinë Tiranë, pjesë e shërbimit civil, është gjithsej 120, i ndarë sipas kategorive të mëposhtme:
 - 3 nëpunës civil, të Nivelit të Lartë Drejtues
 - 6 nëpunës civil, të Nivelit të Mesëm Drejtues;
 - 20 nëpunës civil, të Nivelit të Ulët Drejtues;
 - 91 nëpunës civil, të Kategorisë Ekzekutive;
2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë:
 - Shkenca juridike;
 - Shkenca kompjuterike/electronike;
 - Shkenca ekonomike;
 - Shkenca ekonomike/juridike;
 - Shkenca shoqërore;
 - Shkenca sociale;
 - Agronomi ose një nga degët e Universitetit Bujqësor;
 - Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
 - Shkenca inxhinierike;
 - Arkitekturë;
 - Gjeodezi;
 - Arsimit i lartë.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion Veliaj

